

**Aneksi A****SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

| Nr. | Pozicioni i punës | Struktura e interesuar/<br>Forca | Vendi ku ndodhet | Lloji i kontratës së punës | Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve |            | Afati i aplikimit |            |
|-----|-------------------|----------------------------------|------------------|----------------------------|-----------------------------------------|------------|-------------------|------------|
|     |                   |                                  |                  |                            | Me dosje                                | Intervista | Fillimi           | Mbarimi    |
| 1   | <b>Specialist</b> | Reparti Ushtarak nr.6026, AKMC   | Tiranë           | 6 - mujore                 | Po                                      | Po         | 02.06.2020        | 04.06.2020 |
| 2   |                   |                                  |                  |                            |                                         |            |                   |            |
| 3   |                   |                                  |                  |                            |                                         |            |                   |            |

Formulari nr. 1

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1.Pozicioni i punës:</b> Specialist, në Sektorin e Shtypit, Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>2. Kodi i pozicionit:</b> N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>3. Reparti/Institucioni:</b> Reparti Ushtarak Nr.6026, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>4. Vendi:</b> Tiranë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| <b>5. Paga:</b> VKM nr.47, datë 22.01.2020, i ndryshuar, IV-b.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>6. Lloji i kontratës së punës:</b> 6 - mujore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>7. Data e fillimit të aplikimit:</b> 02.06.2020                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>8. Data e mbylljes së aplikimit:</b> 04.06.2020                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>9. Mënyra e aplikimit:</b><br><br>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a> . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do të dërgohet në:<br><br><i>Drejtorinë e Miradministrit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i><br><br><i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i><br><br><i>Tiranë</i> |

## 10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al). (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

## 11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

## 12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Specialist
- b. Arsimi : Gazetari, Marketing, Shkenca Komunikimi, Shkenca Politike, Gjuhë Letërsi, Gjuhë e Huaj
- a. Kualifikimi: Bachelor
- b. Trajnimi: Trajnim në fushën e kërkuar
- c. Eksperienca në Punë: Të ketë eksperiencë pune mbi 1 vit.
- d. Gjuha e huaj: Anglisht
- e. Kërkesa të tjera specifike: Të ketë njohuri të mira në fushën e kërkuar.
- f. Niveli i certifikatës së sigurisë: N/A

### **Përshkrimi i punës:**

**Deklarimi i pozicionit:** Përgjigjet për zbatimin e procedurave për realizimin e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm të institucionit.

### **Detyrat kryesore:**

1. Përgatit komunikimin e informacioneve me interes ndaj medias e publikut, në përputhje me dispozitat ligjore, në mënyrë transparente, korrekte dhe të besueshme.
2. Përgatit për publikim dhe përditëson në faqen web të institucionit të të gjitha informacioneve zyrtare, buletinet e ndryshme javore, mujor, etj., me qëllim transparencën ndaj publikut.
3. Merr pjesë në hartimin e dokumenteve të promovimit/ informimit, në format shtypi ose elektronik.
4. Merr pjesë në organizimin e eventeve të institucionit.
5. Organizon pritjet me qytetarët, administron portalin e ankesave online, si dhe ndjek ecurinë e kthimit të përgjigjeve për të interesuarit.
6. I mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, duke u konsultuar me dokumentin origjinal, ose duke marrë një kopje të tij, në përputhje me kuadrin ligjor.
7. Krijon, mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave administrative drejtuar institucionit dhe përgjigjeve brenda afatit dhe mënyrës së parashikuar në ligj.
8. Kryen rolin e koordinatorit për të drejtën e informimit kur i delegohet nga Përgjegjësi i Sektorit ose autorizohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

### **13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.  
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë, e cila do të bëhet **ONLINE**.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

**Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

**Intervista** e cila do të behet **ONLINE**, zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.